



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER LEDINA A. MALAJ  
ADRESA NR.2, BLV"ZHAN DARK",  
NR.1, NR.11  
TEL: 692557874

# KONTRATA TE TJERA

(KONTRATË BASHKËPUNIMI)

Nr. repertori: 810

Nr. koleksioni: 332

Tirane më 11/05/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2020052750015742407



A2020052750015742407



**KONTRATË BASHKËPUNIMI  
PËR THEMELIMIN E SHOQERISE SE THJESHTE  
"D.O. PHYSIO"**

Sot, më datë 11.05.2020 , para meje Notere LEDINA A. MALAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.2, BLV"ZHAN DARK", NR.1, NR.11, u paraqit personalisht:

**ANETARET THEMELUES:**

**PALA 1:**

Diter Stambo, atësia Vangjel, amësia Zamira, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, Tiranë dhe banues në TIRANE, me adresë B.Curri, lindur më 06/06/1993, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 030866436 dhe nr. personal J30606054M, .

**PALA 2:**

Olsi Face, atësia Pandeli, amësia Nina, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë, Korçë dhe banues në TIRANE, me adresë 1023 Njesia bashkiake nr. 7 'Kavajes' 12Katesh 2 26, lindur më 07/10/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 027641086 dhe nr. personal I01007056N, .

Te dy së bashku me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë të shprehur nëpërmjet kësaj kontrate themelimi ranë dakord Për krijimin e Shoqërisë Së Thjeshtë "D.O. PHYSIO", me kushtet e mëposhtme.

**NENI 1**

"D.O. PHYSIO" themelohet si shoqëri e thjeshtë, bazuar në dispozitat 1074-1112 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria e Thjeshtë është Person Juridik Privat.

**Selia e saj ndodhet në adresën: Rr. Abdyl Frasheri, P.11, Hyrja Nr.8, Njesia Administrative Nr.5, Tiranë.**

**NENI 2**

Veprimtaria e Shoqërisë bazohet në standardet e kësaj Kontrate Themelimi, si dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Themeluesit e saj mbajnë përgjegjësi vetëm Për detyrimet që krijon Shoqëria e Thjeshtë





### NENI 3

Kapitali themeltar i Shoqërisë së thjeshtë është i përbërë nga kontributi i anëtarëve themelues në vlerën 1000 (njëmijë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga Anëtarët Themelues në këtë mënyrë:

1. **Z. Diter Stambo** në masën 50 % të vlerës së kapitalit themeltar ose 500 leke kontribut, **1 kuote**
2. **Z. Olsi Face** në masën 50 % të vlerës së kapitalit themeltar ose 500 leke kontribut, **1 kuote**

Vlerësimi i kapitalit themeltar është bërë nga Anëtarët Themelues me rastin e themelimit të kësaj Kontrate Themelimi dhe është nënshkruar prej tyre.



### NENI 4

Shoqëria ka likujduar kapitalin në të holla, në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Themelimi.

Pjesëmarrja ne Shoqeri do te jete:

50 % e kuotes zoterohet nga Anetari Themelues Diter Stambo dhe

50% e kuotes zoterohet nga Anetari Themelues Olsi Face.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria e thjeshtë do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Ofrimin e Sherbimeve ne fushen e fizio-terapise.
- Kryerjen e cdo Iloj aktiviteti tjeter qe ka lidhje te drejteperdrejte ose jo me permbushjen e objektit te siperpermendur te shoqerise.

### NENI 6

Shoqëria e thjeshtë do të ushtrojë aktivitetin me një afat kohor të pa kufizuar. Veprimtaria e shoqërisë do të filloj menjëherë pas rregjistrimit të **Shoqërisë së thjeshtë "D.O. PHYSIO"** në QKB (Qendrën Kombëtare të Biznesit).

### NENI 7

Fitimi i realizuar do të shpërndahet midis Anëtarëve themelues . Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.



## NENI 8

Anëtarët Themelues kanë këto detyrime:

1. Të regjistrojnë Shoqërinë pranë QKB;
2. Të derdhin kapitalin e nevojshëm përfillimin e aktivitetit të Shoqërisë;
3. Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturën e nevojshme etj.;
4. Të sigurojnë mundësitë e specializimit të panderprerë të personelit ndihmës së asistentëve gjithnjë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë të veprimtarisë së ushtruar nga ana e shoqërisë;
5. Të menaxhojnë marketingun dhe reklamën nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

## NENI 9

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Anëtarëve.
2. Administratorët e Shoqërisë.

Administratore të Shoqërisë do të jenë : Diter Stambo dhe Olsi Face , të dy administratorët do të jenë të emëruar për një afat pesë-vjeçar. Bashkadministrotoret do të kenë të drejta dhe detyrime të barabarta.

## NENI 10

Anëtarët themelues si dhe të gjithë Anëtarët që do të pranohen si të tillë pranë Shoqërisë duke përfshirë edhe bashkëpunëtorët e saj detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë.

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me menaxhimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen që të zhdurojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.



## NENI 11

Në rast mosmarrëveshjes, që lindin për këtë Akt themelimi do të zgjidhen nga vetë Anëtarët themelues me mirëkuptim dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## NENI 12

Kontrata pasi u lexua nga Anëtarët Themelues u nënshkrua prej tyre.

1.   
 2. 



Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**  
**LEDINA A. MALAJ**

Handwritten signature of Ledina A. Malaj in blue ink, written over a circular notary stamp.

